

**LIGJ**  
**Nr.10 300, datë 15.7.2010**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET SHTETEVE PALË NË  
TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT PËR BASHKËPUNIMIN PËR  
INFORMACIONIN ATOMIK”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për bashkëpunimin për informacionin atomik”, si dhe aneksi teknik e i sigurisë së saj, bërë në Paris më 18 qershor 1964.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6650, datë 21.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**KËSHILLI I ATLANTIKUT TË VERIUT**

Kopja N X(88)1583

NATO  
Dokument  
C-M(64)39

**PROJEKTMARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIMIN**  
**NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK**  
**RAPORT NGA GRUPI I PUNËS**

1. Në mbledhjen e tij të datës 31 korrik 1963(1), Këshilli shqyrtoi një shënim të Sekretarit të Përgjithshëm, të cilit i ishte bashkëngjitur një memorandum dhe një projektmarrëveshje e re për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik të paraqitur nga delegacioni i Shteteve të Bashkuara. Këshilli ra dakord të ngrejë një grup pune për ta shqyrtuar këtë projektmarrëveshje dhe t'i paraqesë propozimet në Këshill.

2. Grupi i punës pas kësaj paraqet projektin e një marrëveshjeje të përpiluar duke marrë parasysh komentet e bëra nga delegacionet e ndryshme mbi propozimet fillestare të Shteteve të Bashkuara.

3. Sugjerohet që për lidhjen e Marrëveshjes, duhet të ndiqet një procedurë e ngjashme me atë të miratuar në vitin 1955 për marrëveshjen e mëparshme. Hapi i parë sipas kësaj procedure do të ishte që Këshilli të pranojnë një rezolutë, sipas tekstit të mëposhtëm.

“Këshilli i Atlantikut të Veriut:

*Duke vënë re* që grupi i punës, që u mbledh për të shqyrtuar projekt marrëveshjen e re për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik të propozuar nga Shtetet e Bashkuara palëve të tjera në Traktatin e Atlantikut të Veriut, tashmë ka paraqitur një tekst të pranuar që është bashkëngjitur, dhe

*duke mirëpritur* iniciativën e Shteteve të Bashkuara në propozimin e Marrëveshjes,

*aprovon* projekttekstin e Marrëveshjes, dhe

*u rekomandon* qeverive anëtare që ato të veprojnë në pajtim me kërkesat e tyre kombëtare me qëllim lidhjen e Marrëveshjes.”

4. Hapi i dytë do të ishte që çdo shtet ta nënshkruajë atë sipas kushteve të kërkesave të tij kushtetuese. Kjo, në rastin e disa shteteve, mund të kërkojë sigurimin e Përfaqësuesve të Përhershëm përkatës të “Plotfuqisë”. Delegacioni i Shteteve të Bashkuara i ka shpjeguar grupit të punës që proceset e veta të brendshme do të lehtësoheshin së tepërmi nëse nënshkrimet do të vireshin në Marrëveshje menjëherë sapo secili shtet i veçantë të ishte gati për ta bërë këtë sesa të priste deri sa shteti i fundit të jetë në gjendje për ta nënshkruar dhe pastaj të gjithë ta nënshkruajnë njëkohësisht. Grupi i punës rekomandon në mënyrë unanime që procedura e sugjeruar nga Shtetet e Bashkuara duhet të miratohet. Kjo pikëpamje është e pasqyruar në nenin 12 të tekstit të vetë Marrëveshjes.

5. Së treti, secili shtet, në pajtim me procedurat e veta kushtetuese, e ratifikon këtë Marrëveshje, që do të hynte në fuqi pasi këtë ta ketë bërë secili shtet.

6. Si në rastin e marrëveshjes së mëparshme, sugjerohet që Marrëveshja e re duhet të deklasifikohet dhe t’i jepet shtypit. Kjo duhet të bëhet në një datë që vendoset nga Këshilli. Megjithatë, të dy anekset duhet të ruajnë klasifikimin e tyre të tashme, dhe natyrisht nuk do t’i jepen shtypit.

7. Së fundi, Marrëveshja, sipas dispozitave të nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duhet t’i komunikohet Organizatës.

8. Rekomandohet që Këshilli duhet të:

a) miratojë një rezolutë të parashikuar në paragrafin 3 më sipër;

b) bien dakord mbi procedurën për nënshkrim dhe ratifikim, të parashikuar në paragrafët 4 dhe 5 më sipër;

c) bien dakord që Marrëveshja duhet të jetë e hapur për nënshkrim dyzet e tetë orë pasi të gjitha delegacionet të jenë njoftuar për konfirmimin përfundimtar të pranimit të rezolutës së paragrafit 3 më sipër nga të gjitha shtetet anëtare;

d) vendosin mbi kohën e deklasifikimit dhe publikimit për shtyp të vetë Marrëveshjes.

(Nënshkruar) Colderidge

Kryetar

OTAN/NATO Paris, XVIe

## MARRËVESHJE

NDËRMJET PALËVE NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT PËR  
BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK

### PREAMBUL

Palët e Traktatit të Atlantikut të Veriut, të nënshkruar në Uashington më 4 prill 1949,  
*Duke ditur* që siguria dhe mbrojtja e tyre e përbashkët kërkon që ata të jenë të përgatitura të përballojnë situatat e mundshme të luftës atomike;

*Duke ditur* që interesat e tyre të përbashkëta do të përparojnë duke i dhënë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të saj anëtare informacion që u përket atyre;

*Duke marrë parasysh* Aktin e Energjisë Atomike të Shteteve të Bashkuara të vitit 1954, i

ndryshuar, që u përgatit duke pasur parasysh këto qëllime;

*Duke vepruar në emër të tyre dhe në emër të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut,*

bien dakord si më poshtë:

#### Neni 1

Në pajtim dhe në përmbushje të kërkesave të Aktit të Energjisë Atomike të Shteteve të Bashkuara të vitit 1954, i ndryshuar, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndërsa Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut vazhdon të japë kontribute thelbësore dhe materiale për mbrojtjen dhe sigurinë e përbashkët, do të bashkëpunojë duke i komunikuar herë pas here Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të saj anëtare, ndërsa këta vazhdojnë t'i japin këto kontribute, informacion atomik, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të përcaktojë se ky bashkëpunim do të nxisë dhe nuk do të përbëjë një rrezik të paarsyeshëm për mbrojtjen dhe sigurinë e saj.

#### Neni 2

Duke ndjekur detyrimin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës sipas kësaj Marrëveshjeje, shtetet e tjera, anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, në masën që ata e konsiderojnë të nevojshme, i komunikojnë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, duke përfshirë elementet e saj ushtarake dhe civile, dhe shteteve anëtare informacion atomik që buron prej tyre për të njëjtat lloje që parashikohen në këtë Marrëveshje. Termat dhe kushtet që rregullojnë këto komunikime të shteteve të tjera anëtare janë objekt i marrëveshjeve të tjera, por do të jenë të njëjta ose të ngjashme me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

#### Neni 3

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i komunikon Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, duke përfshirë elementet e saj ushtarake dhe civile, dhe shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut që kërkojnë informacion atomik në lidhje me funksionet e tyre për sa u takon misionet e NATO-s, ku ky informacion atomik përcaktohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si i nevojshëm për:

- a) zhvillimin e planeve të mbrojtjes;
- b) trajnimin e personelit në aplikimin dhe mbrojtjen nga armët atomike dhe aplikimet e tjera ushtarake të energjisë atomike;
- c) vlerësimin e aftësive të armiqve të mundshëm në përdorimin e armëve atomike dhe aplikimeve të tjera ushtarake të energjisë atomike;
- d) zhvillimin e sistemeve të shpërndarjes të përshtatshme për armët atomike që ata kanë.

#### Neni 4

1. Bashkëpunimi sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në pajtim me ligjet e saj të zbatueshme.

2. Sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të ketë transferime nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të armëve atomike, pjesëve jobërthamore të armëve atomike, ose pjesëve jobërthamore të sistemeve të armëve atomike që kanë të dhëna të kufizuara.

3. Informacioni atomik që komunikohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, në pajtim me këtë Marrëveshje, përdoret ekskluzivisht për përgatitjen ose zbatimin e planeve dhe aktiviteteve të NATO-s për mbrojtjen dhe zhvillimin e sistemeve të shpërndarjes në interes të përbashkët të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

## Neni 5

1. Informacionit atomik të komunikuar në pajtim me këtë Marrëveshje i jepet mbrojtje e plotë e sigurisë sipas rregulloreve dhe procedurave të zbatueshme të NATO-s, masave të miratuara për sigurinë, legjislacionit dhe rregulloret e brendshme. Në asnjë rast Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut apo shtetet e saj anëtare nuk mbajnë standarde sigurie për garantimin e informacionit atomik më pak të kufizuar se ato të parashikuara në rregulloret përkatëse të NATO-s për sigurinë dhe masat e tjera të miratuara për sigurinë në fuqi në datën që kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

2. Vendosja dhe bashkërendimi i programit të sigurisë në të gjitha elementet ushtarake dhe civile të NATO-s realizohet nën autoritetin e Këshillit të Atlantikut të Veriut, në pajtim me procedurat e parashikuara në masat e miratuara për sigurinë.

3. Informacioni atomik i komunikuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në pajtim me këtë Marrëveshje, ofrohet nëpërmjet kanaleve të komunikimit të informacionit atomik që ekziston tashmë ose që miratohet më vonë.

4. Informacioni atomik i komunikuar ose shkëmbyer, në pajtim me këtë Marrëveshje, nuk i komunikohet ose shkëmbehet nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut ose persona nën juridiksionin e saj me asnjë person të paautorizuar ose, përveç kur parashikohet në paragrafin 5 të këtij neni, përtej juridiksionit të asaj Organizate.

5. Përveç kur përcaktohet ndryshe nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, informacioni atomik i Shteteve të Bashkuara i dhënë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut mund t'u komunikohet nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut shteteve të saj anëtare sipas nevojës për të përmbushur funksionet në lidhje me misionet e NATO-s, me kusht që shpërndarja e këtij informacioni atomik brenda këtyre shteteve anëtare të jetë i kufizuar tek ata individë të veçantë që kanë të bëjnë me misionet e NATO-s për të cilat kërkohet informacioni. Shtetet anëtare bien dakord që informacioni atomik i marrë në këtë mënyrë nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut ose ndryshe në pajtim me këtë Marrëveshje nuk u transferohet personave të paautorizuar ose përtej juridiksionit të shtetit anëtar marrës; megjithatë, ky informacion mund t'i komunikohet Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut ose, kur autorizohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shteteve të tjera anëtare që kërkojnë informacionin për funksionet në lidhje me misionet e NATO-s.

## Neni 6

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mund të vendosë shkallën në të cilën një informacion atomik i dhënë prej saj Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut ose shteteve anëtare mund të shpërndahet; mund të përcaktojë kategoritë e personave që kanë akses te ky informacion, dhe mund të vendosë kufizime të tjera mbi shpërndarjen e informacionit që ajo i konsideron të nevojshme.

## Neni 7

1. Një palë që merr informacion atomik sipas kësaj Marrëveshjeje, e përdor atë vetëm për qëllimet e specifikuar në të. Çdo shpikje ose zbulim që rrjedh nga zotërimi i këtij informacioni nga ana e një pale marrëse ose personi nën juridiksionin e saj i ofrohet falas Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për qëllime mbrojtjeje në pajtim me ato masa që mund të bihen dakord dhe garantohen në pajtim me dispozitat e nenit V të kësaj Marrëveshjeje.

2. Zbatimi ose përdorimi i çdo informacioni të komunikuar sipas kësaj marrëveshjeje, është përgjegjësi e palës që e merr atë; pala që komunikon informacionin nuk jep asnjë kompensim apo garanci në lidhje me zbatimin apo përdorimin e tij.

## Neni 8

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk konsiderohet sikur zëvendëson ose ndikon ndryshe në marrëveshjet dypalëshe ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje që parashikon bashkëpunim në shkëmbimin e informacionit atomik.

## Neni 9

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Armë atomike” është çdo mjet që përdor energjinë atomike, përveç pajisjes së transportit ose drejtimit të mjetit (nëse kjo pajisje është pjesë e ndashme e mjetit), qëllimi kryesor i së cilës është përdorimi ose zhvillimi i një arme, prototipi arme ose një mjeti prove për armët.

b) “Informacion atomik” që jepet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, sipas kësaj Marrëveshjeje, është informacioni që është përcaktuar “Të dhëna të kufizuara” ose “Të dhëna të kufizuara më parë” nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## Neni 10

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me marrjen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të njoftimit nga të gjitha palët në Traktatin e Atlantikut të Veriut që ato dëshirojnë të respektojnë termat e Marrëveshjes.

2. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri sa të përfundohet me marrëveshje unanime apo të zëvendësohet nga një marrëveshje tjetër, ku është e kuptueshme, sidoqoftë, që përfundimi i kësaj Marrëveshjeje si e tërë nuk i liron palët nga kërkesat e kësaj Marrëveshjeje për të garantuar informacionin e ofruar në pajtim me të.

## Neni 11

Pavarësisht dispozitave të nenit VI(4) të Marrëveshjes ndërmjet palëve në Traktatin e Atlantikut të Veriut për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, të nënshkruar në Paris më 22 qershor 1955, kjo Marrëveshje, me hyrjen e saj në fuqi, zëvendëson Marrëveshjen e sipërpërmendur, ku kuptohet që informacioni i dhënë, sipas asaj Marrëveshjeje, konsiderohet për të gjitha qëllimet të jetë komunikuar sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 12

Kjo Marrëveshje ka datën në të cilën hapet për nënshkrim dhe mbetet e hapur për nënshkrim derisa të jetë nënshkruar nga të gjitha shtetet palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të shteteve të tyre përkatëse, anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, dhe në emër të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Bërë në Paris, në ditën e 18 të qershorit 1964, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dy tekstet janë njëjloj të barasvlershme, në një kopje të vetme origjinale, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës transmeton kopje të vërtetuara të saj të gjitha shteteve nënshkruese dhe aderuese.

Për Mbretërinë e Belgjikës:

Për Kanadanë:  
Për Mbretërinë e Danimarkës:  
Për Francën:  
Për Republikën Federale Gjermane:  
Për Mbretërinë e Greqisë:  
Për Islandën:  
Për Italinë:  
Për Dukatën e Madhe të Luksemburgut:  
Për Mbretërinë e Holandës:  
Për Mbretërinë e Norvegjisë:  
Për Portugalinë:  
Për Turqinë:  
Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:  
Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës:

## ANEKS TEKNIK PËR MARRËVESHJEN NDËRMJET PALËVE NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK

Dispozitat e këtij aneksi zbatohen disa nga dispozitat e Marrëveshjes për bashkëpunim në lidhje me informacionin atomik të bërë në Paris, më 18 qershor 1964 (këtej e tutje referuar si Marrëveshja) pjesë integrale e së cilës është ky aneks.

### SEKSIONI I

Sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes, tipet e informacionit atomik që Qeveria e Shteteve të Bashkuara mund t'i japë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të asaj anëtare janë:

A. Siç mund të jetë e nevojshme për planifikimin e mbrojtjes së përbashkët, trajnimin dhe kërkesat për logjistikë, informacioni në lidhje me shifrat, vendndodhjet, tipet, kapacitetet, armatimi, sigurimin, komandën dhe kontrollin dhe detonuesit e atyre armëve atomike që mund të ofrohen për përdorim nga ose në mbështetje të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

B. Efektet që priten ose rrjedhin nga detonimi i armëve atomike.

C. Reagimet e strukturave, pajisjeve, komunikimeve dhe personelit ndaj efekteve të armëve atomike, duke përfshirë kriteret e dëmeve dhe humbjeve në njerëz.

D. Metodot dhe procedurat për analizat në lidhje me efektet e armëve atomike.

E. Informacioni mbi aftësitë e shteteve armike potenciale për luftën atomike.

F. Informacioni mbi armët atomike dhe sistemet e armëve atomike që kërkohen për zotërimin e aftësisë së dorëzimit për armë të caktuara atomike që mund të ofrohen për përdorim nga ose në mbështetje të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, duke përfshirë informacionin e kërkuar për vlerësimin e sistemeve të armëve atomike për të përcaktuar kërkesat dhe strategjinë e NATO-s.

G. Informacioni në lidhje me sistemet e dorëzimit, duke përfshirë taktikat dhe teknikat dhe detyrat e mirëmbajtjes, montimit, personelit të dorëzimit dhe aktivizimit që kërkohen për zotërimin e aftësisë së dorëzimit të armëve të caktuara atomike.

H. Në masën që ato ndikojnë në planifikimin e NATO-s, rezultatet që priten nga ofensiva strategjike ajrore.

I. Informacioni i kërkuar për arritjen e përputhshmërisë së armëve të caktuara atomike me automjetet e përcaktuara të dorëzimit.

J. Tiparet e sigurisë së armëve të përcaktuara atomike dhe të sistemeve operative që shoqërojnë këto armë dhe informacioni i nevojshëm dhe i përshtatshëm për operacionet e

shpëtimin dhe rikuperimin si pasojë e një aksidenti me armë.

K. Informacioni i kërkuar për planifikimin dhe trajnimin e personelit në përdorimin dhe mbrojtjen kundër armëve atomike dhe duke përfshirë informacionin në lidhje me:

1. Përdorimet ushtarake të izotopeve për qëllime mjekësore;
2. Mbrojtja kundër luftës radiologjike.

L. Informacion në lidhje me mbrojtjen civile kundër sulmeve atomike.

M. Informacioni tjetër që mund të përcaktohet nga Autoritetet e Shteteve të Bashkuara si i nevojshëm për mbështetjen e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe i transferueshëm sipas dispozitave të Aktit të Energjisë Atomike të vitit 1954, i ndryshuar, si dhe Marrëveshjes.

## SEKSIONI II

Asnjë informacion mbi aplikimet e tjera ushtarake të energjisë atomike, reaktorëve ushtarakë, impiantet e drejtimit nuklear detar, nuk komunikohen në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Për Mbretërinë e Belgjikës:

Për Kanadanë:

Për Mbretërinë e Danimarkës:

Për Francën:

Për Republikën Federale Gjermane:

Për Mbretërinë e Greqisë:

Për Islandën:

Për Italinë:

Për Dukatën e Madhe të Luksemburgut:

Për Mbretërinë e Holandës:

Për Mbretërinë e Norvegjisë:

Për Portugalinë:

Për Turqinë:

Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës:

## ANEKS SIGURIE I MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK

Ky aneks parashikon masat e sigurisë që Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shtetet anëtare zbatojnë për të garantuar informacionin atomik të dhënë nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të saj anëtare, në pajtim me Marrëveshjen për bashkëpunim në lidhje me informacionin atomik të bërë në Paris, më 18.6.1964 (këtej e tutje referuar si “Marrëveshja”) pjesë integrale e së cilës është ky aneks. Në rast se një anëtar tjetër i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut i ndryshëm nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës jep një informacion atomik në pajtim me nenin II të Marrëveshjes, ky informacion garantohet nga masat e sigurisë jo më pak kufizuese se ato të parashikuara në këtë aneks.

## SEKSIONI I

## TË PËRGJITHSHME

A. Rregulloret e NATO-s për sigurinë, jo më pak kufizuese se ato që tashmë parashikohen në C-M(55)15(Përfundimtare) dhe shtojcën konfidenciale të 1 janarit 1961, si dhe masat e sigurisë të përcaktuara në këtë aneks, zbatohen nga elementet ushtarake dhe civile të NATO-s dhe nga shtetet anëtare të informacionit atomik që komunikohet në pajtim me këtë Marrëveshje.

B. Programet e sigurisë që zbatohen nga të gjitha elementet ushtarake dhe civile të NATO-s dhe nga shtetet anëtare që marrin informacion atomik, në pajtim me Marrëveshjen, parashikojnë plotësisht zbatimin e kërkesave për sigurinë të parashikuara në këtë aneks.

C. Sekretari i Përgjithshëm, duke vepruar në emër të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe nën autoritetin e tij, është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të programit të NATO-s për sigurinë për mbrojtjen e informacionit atomik sipas kësaj Marrëveshjeje. Ai garanton me anë të procedurave të parashikuara në seksionin X të këtij aneksi që të gjitha masat e kërkuara nga programet e NATO-s për sigurinë të përfshihen në elementet civile dhe ushtarake të NATO-s dhe elementet civile dhe ushtarake kombëtare për të mbrojtur informacionin që shkëmbehet në bazë të Marrëveshjes.

D. Asnjë individ nuk ka të drejtë të hyjë në informacionin atomik vetëm për shkak të gradës, emërimit apo certifikatës së sigurisë.

E. Aksesit në informacionin atomik të dhënë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut është i kufizuar për shtetasit e shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut që u është dhënë certifikata e sigurisë, në pajtim me seksionin II të këtij aneksi dhe përgjegjësitë e të cilëve kërkojnë akses në informacion.

F. Aksesit në informacionin atomik që i është dhënë një shteti anëtar, në pajtim me Marrëveshjen, është i kufizuar te shtetasit e tij të cilëve u është dhënë certifikatë sigurie në pajtim me seksionin II të këtij aneksi dhe detyrat e të cilëve kërkojnë akses, me qëllim që shteti anëtar të përmbushë përgjegjësitë dhe detyrimet e tij ndaj Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

## SEKSIONI II SIGURIA E PERSONELIT

A. Asnjë individ nuk i jepet certifikatë sigurie për akses në informacionin atomik, përveç kur përcaktohet që kjo certifikatë nuk rrezikon sigurinë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut ose sigurinë kombëtare të shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

B. Para dhënies së aksesit në informacionin atomik, përcaktimi i pranueshmërisë (vendimi për dhënien e certifikatës së sigurisë) për çdo individ për dhënien e këtij aksesit bëhet nga një autoriteti përgjegjës i qeverisë së individit përkatës.

C. Vendimi nëse dhënia e një certifikate të sigurisë është qartësisht në pajtim me interesat e sigurisë përcaktohet në bazë të gjithë informacionit të dhënë. Para këtij përcaktimi, bëhet një hetim nga një autoritet përgjegjës i qeverisë dhe informacioni i mbledhur rishikohet duke marrë parasysh tipet kryesore të informacionit devijues që ngre dyshime në lidhje me pranueshmërinë e individit për certifikatën e sigurisë, siç janë parashikuar në seksionin III të shtojcës konfidenciale të datës 1 janar 1961, tek C-N(55)15(Përfundimtare).

D. Objekti dhe masa minimale e hetimit është në pajtim me standardet e parashikuara në seksionin II të shtojcës konfidenciale të C-N(55)15(Përfundimtare), përveç kur kërkohet një hetim të rrethanave për certifikatë për akses në informacionin atomik të klasifikuar Sekret për individët e ndryshëm nga anëtarët e Forcave të Armatosura ose personelin civil të strukturave ushtarake të shteteve anëtare.

E. Çdo strukturë që trajton informacion atomik mban një regjistër të përshtatshëm për

certifikimin e individëve të autorizuar për të pasur akses në këtë informacion në strukturë. Çdo certifikatë rishikohet, sipas rastit, për të siguruar që ai është në pajtim me standardet e tashme të zbatueshme për përfshirjen e individit, dhe rishqyrtohet si prioritet kur merret informacioni që tregon se vazhdimi i përfshirjes me akses në informacionin atomik nuk mund të jetë më në pajtim me interesat e sigurisë.

F. Ndërlidhja efektive mbahet në çdo shtet ndërmjet agjencive kombëtare përgjegjëse për sigurinë kombëtare dhe autoritetit përgjegjës për marrjen e vendimeve për certifikatat për të siguruar njoftim të menjëhershëm të informacionit me implikime devijuese që zhvillohet pas dhënies së certifikatës së sigurisë.

### SEKSIONI III SIGURIA FIZIKE

A. Informacioni atomik mbrohet fizikisht kundrejt spiunazhit, sabotimit, aksesit të paautorizuar ose çdo aktivitet tjetër armiqësor. Kjo mbrojtje bëhet në përputhje me rëndësinë e interesit përkatës të sigurisë.

B. Programet për sigurinë fizike të informacionit atomik përpilohen për të siguruar:

1. Mbrojtje të përshtatshme të informacionit atomik të disponueshëm për përdorim të menjëhershëm, në ruajtje ose tranzit.

2. Krijimi i zonave të sigurisë me akses të kontrolluar, kur konsiderohen të nevojshme për shkak të ndjeshmërisë, karakterit, volumit dhe përdorimit të informacionit të klasifikuar atomik dhe karakterit dhe vendndodhjes së ndërtesës apo të ndërtesave përkatëse.

3. Një sistem me akses së kontrolluar që përfshin procedurat për një autoritet kompetent për të autorizuar aksesin, metoda të sakta të identifikimit të personelit dhe përgjegjshmërinë për mjete të identifikimit; dhe një mjet për zbatimin e kufizimeve të lëvizjes brenda dhe aksesit në zonat e sigurisë.

C. Dispozitat e paragrafëve B më sipër do të jenë shtesë e procedurave të parashikuara në seksionin IV të C-M(55)15(Përfundimtare).

### SEKSIONI IV KONTROLI I INFORMACIONIT ATOMIK

A. Mbahen programet e kontrollit të informacionit që kanë si qëllime të tyre kryesore:

1. Kontrollin e aksesit;

2. Përgjegjshmëri e gatshme, në përputhje me shkallën e ndjeshmërisë.

3. Asgjësim nëse nuk vazhdon të nevojitet.

B. Klasifikimet e sigurisë të zbatuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara për informacionin atomik të komunikuar sipas Marrëveshjes respektohen përgjithmonë; rikategorizimi ose deklasifikimi mund të bëhet vetëm me aprovimin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

C. Dokumentet që përmbajnë informacion atomik të Shteteve të Bashkuara, të komunikuar sipas kësaj Marrëveshjeje, mbajnë shënimet e NATO-s dhe një klasifikim sigurie të barasvlershëm me atë që caktohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që pasohet nga fjala ATOMAL. Përveç kësaj, shënimi i mëposhtëm futet në dokument në gjuhën e dokumentit:

“Ky dokument përmban informacion atomik të Shteteve të Bashkuara (Të dhëna të kufizuara ose të dhëna të kufizuara më parë) të dhënë në bazë të Marrëveshjes së NATO-s për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, të nënshkruar nga 18 qershor 1964 dhe garantohet përkatësisht.”

D. Të dhënat e përgjegjshmërisë mbahen për të gjitha dokumentet Tepër Sekret dhe Sekret dhe për të gjitha dokumentet për të cilat kufizimet e veçanta janë vendosura në pajtim me nenin VI të Marrëveshjes. Këto të dhëna tregojnë identitetin e të gjithë marrësve të dokumenteve

mbi të cilat janë vendosur kufizime të veçanta.

E. Riprodhimi, duke përfshirë ekstraktet dhe përkthimet, e dokumenteve që përmbajnë informacion atomik të Shteteve të Bashkuara që kanë shënimet e specifikuar në paragrafin C më sipër mund të bëhen sipas rregullave të mëposhtme:

1. Dokumentet e klasifikuara Sekret dhe Tepër Sekret mund të riprodhohen vetëm me aprovimin paraprak të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto dokumente kanë një shënim të përshtatshëm për këtë qëllim. Në situata emergjence, nëse aprovim paraprak nuk mund të merret në kohë, mund të hiqet dorë nga ky rregull, por Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informohet për këtë me anë të mjeteve më të shpejta.

2 Dokumentet e klasifikuara Konfidenciale mund të riprodhohen vetëm nëse është e nevojshme për të përmbushur kërkesat faktike.

3. Riprodhimet, duke përfshirë ekstraktet dhe përkthimet, mbajnë të gjitha shënimet e sigurisë (duke përfshirë shënimin e përshkruar në paragrafin C) të gjetura në dokumentin origjinal dhe vendosen nën kontrollin e përgjegjshmërisë që zbatohen për dokumentet origjinale. Nëse paragrafët kanë klasifikime të ndara, klasifikimi i sigurisë së dokumenteve që kanë informacion atomik të nxjerrë mban klasifikimin e paragrafit me klasifikimin më të lartë nga i cili janë nxjerrë ekstraktet dhe, sipas rastit, shënimin e përcaktuar në paragrafin C. Kontrollin e përgjegjshmërisë për informacionin atomik të nxjerrë janë sipas parashikimit në paragrafin D të këtij seksioni. Për më tepër, ato kufizime të veçanta që mund të jenë vendosur në dokumentin origjinal zbatohen edhe për dokumentet që përmbajnë ekstraktet.

F. Dokumentet e përgatitura për të regjistruar informacionin atomik të marrë sipas Marrëveshjes me mjete verbale apo vizuale kanë shënimet e përcaktuara në paragrafin C më sipër dhe u nënshtrohen rregullave për përgjegjshmërinë dhe kontrollin e zbatueshëm për nivelin e klasifikimit përkatës.

## SEKSIONI V KANALET E TRANSMETIMIT

Komunikimet e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës të informacionit atomik sipas Marrëveshjes, duke përfshirë komunikimet verbale dhe vizuale, bëhen nëpërmjet kanaleve që ekzistojnë ose që mund të miratohen më vonë. Për të asistuar Sekretarin e Përgjithshëm për përmbushjen e përgjegjësisë së tij për sigurinë sipas paragrafit C të seksionit I të këtij aneksi, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i jep Sekretarit të Përgjithshëm informacion të plotë për të identifikuar çdo komunikim me shkrim të informacionit atomik nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe çdo komunikim të autorizuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës sipas kësaj Marrëveshjeje. Ky informacion do të dërgohet gjithashtu te Grupi i Përhershëm për të gjitha komunikimet e bëra për elementet ushtarake.

## SEKSIONI VI RAPORTET

A. Çdo shtet anëtar dhe element ushtarak dhe civil i NATO-s që merr informacion atomik të Shteteve të Bashkuara sipas Marrëveshjes i paraqet brenda 31 marsit të çdo viti duke përdorur kanalet që ekzistojnë ose që mund të miratohen më vonë, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës një raport që përmban sa më poshtë:

1. Një listë të të gjitha dokumenteve atomike të marrë nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë dymbëdhjetë muajve që mbarojnë më 31 dhjetor të vitit të kaluar.

2. Një të dhënë të shpërndarjes së dokumenteve të renditura në paragrafin 1 të mësipërm, dhe

3. Një vërtetim që është bërë një listë fizike e të gjitha dokumenteve atomike për të cilat

shteti anëtar ose elementi ushtarak ose civil i NATO-s është përgjegjës sipas Marrëveshjes. Vërtetimi përfshin një listë të të gjitha dokumenteve të papërfshira, me një deklaram për rezultatet e hetimit të humbjes dhe masat korrigjuese të marra për të penguar përsëritjen.

B. Nëse informacioni atomik i Shteteve të Bashkuara i komunikuar sipas Marrëveshjes komprometohet me humbjen e dokumenteve ose ndonjë mjet tjetër, një raport i menjëhershëm që përfshin të gjithë informacionin përkatës, në lidhje me komprometimin, duke përdorur kanalet ekzistuese ose që mund të miratohen më vonë, i bëhet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## SEKSIONI VII EDUKIMI I SIGURISË

Shtetet anëtare dhe elementet ushtarake dhe civile të NATO-s që marrin informacion sipas Marrëveshjes mbajnë një program të përshtatshëm për të siguruar që të gjithë individët, të cilëve u autorizohet akses në informacionin atomik të informohen për përgjegjësitë e tyre për garantimin e atij informacioni. Programi përfshin një sugjerim dhe orientim fillestar specifik periodik, rithëksim periodik të përgjegjësiwe individuale dhe një intervistë përmbyllëse që thekson përgjegjësitë në vazhdim për mbrojtjen e informacionit atomik.

## SEKSIONI VIII SIGURIA E KONTRATAVE TË KLASIFIKUARA

Çdo kontratë e klasifikuar, nënkontratë, marrëveshje konsulence ose masë tjetër e marrë përsipër nga palët në Marrëveshje, përmbyshja e të cilave ka të bëjë me aksesin në informacionin atomik të shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje, përmban dispozita përkatëse që vendosin detyrime mbi palët private të përfshira për të respektuar masat e sigurisë të parashikuara në këtë aneks.

## SEKSIONI IX RISHIKIMI I VAZHDUESHËM I SISTEMIT TË SIGURISË

A. Njihet që zbatimi efektiv dhe i menjëhershëm i politikave të sigurisë mund të përparohet materialisht nëpërmjet vizitave reciproke të personelit të sigurisë. Është rënë dakord të vazhdohet me një shkëmbim të hollësishëm të mendimeve në lidhje me politikat, standardet dhe procedurat e sigurisë, dhe t'u lejohet grupeve të punës të sigurisë të Shteteve të Bashkuara të shqyrtojnë dhe të shohin drejtpërdrejt procedurat dhe praktikat e agjencive të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të agjencive të shteteve anëtare përgjegjëse për mbrojtjen e dokumenteve dhe informacionit të komunikuar sipas Marrëveshjes, këto vizita ndërmerren me qëllim arritjen e një marrëveshjeje mbi përshtatshmërinë dhe krahasueshmërinë e arsyeshme të sistemeve përkatëse të sigurisë.

B. Sekretari i Përgjithshëm dhe Grupi i Përhershëm në rastin e vizitave në elementet ushtarake, do të informohet për këto vizita dhe do t'i jepen raporte që parashtrojnë konstatimet përkatëse të grupeve të punës së Shteteve të Bashkuara pas çdo vizite. Të gjitha vizitat tek elementet kombëtare do të kryhen në pajtim me autoritetet e sigurisë kombëtare të shteteve përkatëse.

## SEKSIONI X INSPEKTIMET E SIGURISË

A. Inspektimi gjithëpërfshirës i sigurisë i të gjitha elementeve civile dhe ushtarake të

NATO-s dhe shteteve anëtare që kanë marrë informacion atomik, sipas Marrëveshjes, bëhet rregullisht, por jo më pak se një herë çdo dymbëdhjetë muaj, në pajtim me kriteret e parashikuara në seksionin I, paragrafi A i këtij aneksi. Këto inspektime bëhen nga agjencitë e NATO-s që kanë përgjegjësinë për zbatimin e programeve të sigurisë së NATO-s, duke përdorur personel të kualifikuar. Këshilli, nëse e gjykon të nevojshme dhe të përshtatshme, mund të drejtojë kryerjen e inspektimeve të veçanta dhe të emërojë ekipet *ad hoc* të inspektimeve që përbëhet nga personeli i agjencive civile dhe ushtarake të NATO-s ose personel tjetër i kualifikuar. Vizitat në elementet ushtarake dhe civile të shteteve anëtare bashkërendohen me autoritetet përkatëse kombëtare.

B. Të gjitha fazat e programit të sigurisë shqyrtohen dhe brenda tridhjetë ditëve pas përfundimit të inspektimit, një raport me shkrim që përshin një listë të çdo mangësie të gjetur në zbatimin e rregulloreve të sigurisë i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm.

C. Kopje të këtyre raporteve të inspektimeve i ofrohen nga Sekretari i Përgjithshëm Shteteve të Bashkuara në pajtim me Marrëveshjen dhe, në pajtim me dispozitat e tjera të saj dhe sipas rastit, njësisë së inspektuar, autoritetit përkatës kombëtar të sigurisë dhe selisë ushtarake.

D. Brenda tridhjetë ditëve pas marrjes së raportit të inspektimit, autoritetet përkatëse të NATO-s ose elementit kombëtar të inspektuar i dërgojnë Sekretarit të Përgjithshëm një raport për veprimet e mara për të korrigjuar të gjitha mangësitë e renditura në raportin e inspektimit. Pas rishikimit të raporteve të inspektimit dhe raporteve për veprime korrigjuese të ndërmarra, Sekretari i Përgjithshëm, duke vepruar në emër të këshillit, sipas rastit, tërheq vëmendjen e autoriteteve kombëtare, Grupit të Përhershëm ose elementit civil përkatës për çdo veprim tjetër që kërkohet për të përmbushur kriteret e sigurisë së NATO-s dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Kopje të raporteve të veprimit korrigjues, si dhe kopje të çdo komenti që vjen nga Sekretari i Përgjithshëm në pajtim me këtë paragraf shpërndahet në të njëjtën mënyrë siç parashikohet në paragrafin C të këtij seksioni për raportet e inspektimit.

E. Në rast se një problem në lidhje me veprimin korrigjues që lind nga një inspektim sigurie mbetet i pazgjidhur pas zbatimit të procedurës së parashikuar në paragrafin D të këtij seksioni, Sekretari i Përgjithshëm e sjell çështjen në vëmendje të Këshillit me rekomandimin që një ekip *ad hoc* inspektimi të caktohet për të hetuar problemin dhe për t'i raportuar Këshillit, i cili pas kësaj ndërmerr veprimin e përshtatshëm.

Për Mbretërinë e Belgjikës:

Për Kanadanë:

Për Mbretërinë e Danimarkës:

Për Francën:

Për Republikën Federale Gjermane:

Për Mbretërinë e Greqisë:

Për Islandën:

Për Italinë:

Për Dukatën e Madhe të Luksemburgut:

Për Mbretërinë e Holandës:

Për Mbretërinë e Norvegjisë:

Për Portugalinë:

Për Turqinë:

Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës: